



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	21.05.2021
Referenc-ë:	07-353/04-88813/21
Për/ Za/ To:	Nol Nushi
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën tuaj me nr protokoll 07-353/04-88813/21 nga Nol Nushi përfaqësues i nismës qytetare për petition për faljen e gjobave të pandemisë me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike me datë 20 Maj 2021 deri më 20 Qershor 2021 dhe vendosja e tendave për mbledhjen e nënshkrimeve në këto lokacione:

1. Sheshi “Zahir Pajaziti”;
2. Sheshi “Nëna Terezë”;
3. Afër “NewBorn”;
4. “Tre Sheshirat” në Pejton;

Në të njëjtën kohë kërkohet edhe hyrja në shesh me kamionetën me targa “01-143-ME” për bartjen e pajisjeve.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe vendosjen e tendave në Sheshin “Zahir Pajaziti”, Sheshin “Nëna Terezë” si dhe të “NewBorn” ndërsa të “Tre Sheshirat” të vendoset tavolinë për shkak të hapësirës së kufizuar me qëllim mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve.

Kamioneta me targa “01-143-ME” mund të hyjë në shesh vetëm për bartje të materialit.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

21.05.2021

Faqe 1 nga 1